



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:187226

Datë: 24.03.2022

Numri i dokumentit: 02834488

**P.nr.03/2020**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË** - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, me gjyqtarin e vetëm gjykues Blerim Halimi, me zyrtarin ligjor Bardh Sylejmani, në lëndën penale ndaj të pandehurit: Sh.H. , për shkak të veprave penale: Falsifikim i dokumenteve nga neni 398 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe veprës penale Mashtrimi me subvencione nga neni 336 paragrafi 1 në lidhje me nenin 28 të KPRK-së në bashkim me veprën penale sipas pikës 1 të aktakuzës, duke vendosur sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.1564/2017 të datës 03.01.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 23.02.2022, në prezencë të Prokurorit të Shtetit Natasha Taniq, të pandehurit dhe mbrojtësit të tij Berat Peci avokat nga Mitrovica, me datën 25.02.2022 në prezencë të mbrojtësit të të pandehurit, shpalli publikisht, ndërsa me datë 23.03.2022 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari:

Sh.H. , nga i ati B. , e ëma F. , e vajzërisë N. , i lindur me ... në fshatin ... Komuna e Leposaviçit, ku edhe jeton, me numër personal ... , ka të kryer studimet Master drejtimi Shkenca politike, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, i martuar, baba i dy fëmijëve, shqiptar, shetas i Republikës së Kosovës.

**ËSHTË FAJTOR**

**SEPSE:**

**1.**Me datë 01.03.2016, në Mitrovicë, edhe pse ka qenë në gjendje të kuptoj rëndësinë e veprës së tij dhe të udhëheqë me veprimet e veta, dhe i vetëdijshëm se vepra e tij është e ndaluar, ka dëshiruar kryerjen e saj, ka ndryshuar dokumentin publik – listën origjinale poseduese numër 25, e cila është lëshuar në emër të S.H. – pronares së patundshmërisë të cekur në të njëjtën, të lëshuar dhe vërtetuar nga personat e autorizuar të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, ashtu që ka shkruar në vend të emrit të pronarit të vërtetë S.H. , emrin A.B. , në vulën ekzisutese të pranimit ka

shkruar datën përkatëse, pastaj të njejtin e ka skanuar dhe fotokopijuar e tërë këtë me qëllim që të njejtin t'a përdorë si të vërtetë, me ç'rast ka qenë i vetëdijshëm për kundërligjshmërinë e veprës.

**Me këtë ka kryer veprën penale Falsifikimi i dokumenteve nga neni 398 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së.**

**SEPSE:**

2.Me datën 31.03.2016 në Mitrovicë, edhe pse ka qenë në gjendje të kuptoj rëndësinë e veprës së tij dhe të udhëheqë me veprimet e veta, dhe i vetëdijshëm se vepra e tij është e ndaluar, ka dëshiruar kryerjen e saj, me rastin e dorëzimit të dokumentacionit të nevojshëm, Agjencisë për Zhvillim, Bujqësi dhe Pylltari, e në lidhje me aplikacionin për fitimin e subvencionit – mjeteve monetare në shumë prej 70,000 euro në emër të parashtrueses të kërkesës A.B. , ka dorëzuar dokumentin publik paraprakisht të ndryshuar – listën poseduese në emër të A.B. , kur nga ana e zyrtarit të Agjencisë në fjalë, për shkak të dokumentacionit të falsifikuar, kërkesa është refuzuar.

**Me këtë ka kryer veprën penale Mashtrimi me subvencione nga neni 336 par.1 në lidhje me nenin 28 të KPRK-së, në bashkim me veprën penale nën pikën 1.**

Andaj Gjykata në bazë të nenit 4, 7, 17, 21, 38, 40, 43, 46, 47, 48, 49, 69, 70, dhe 398 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 dhe nenin 336 paragrafi 1 lidhur me nenin 28 të KPRK-së dhe nenit 359, 360, 361, 365, 366 të KPP-së:

**PËRCAKTON**

- Për veprën penale Falsifikimi i dokumenteve nga neni 398 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, sipas pikës 1, DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej një (1) viti.
- Për veprën penale Mashtrimi me subvencione nga neni 336 par.1 në lidhje me nenin 28 të KPRK-së, sipas pikës 2, DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej tetë (8) muaj.

Gjykata, në bazë të nenit 80 të KPRK-së, të akuzuarin Shaqir Hetemi e:

**GJYKON**

**DËNIM UNIK ME BURGIM ME KUSHT**

- I.** Në kohëzgjatje prej një (1) vit e gjashtë (6) muaj i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari nuk kryen vepër tjetër penale brenda periudhës së verifikimit në kohëzgjatje prej dy (2) vitesh.
- II.** Obligohet i akuzuari që të paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 20€ (njëzet euro), si dhe 30€ (tridhjetë euro) në emër të Fondit për kompenzimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kanosje të përmbartimit me dhunë.

**A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur Aktakuzën PP.II.nr.1564/2017 të datës 03.01.2020, kundër të pandehurit: Sh.H. , për shkak të veprës penale: Falsifikim i dokumenteve nga neni 398 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, dhe veprës penale Mashtrimi me subvencione nga neni 336 paragrafi 1 në lidhje me nenin 28 të të KPRK-së në bashkim me veprën penale si në pikën 1 të aktakuzës.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datën 23.02.2022, ashtu që në këtë seancë i pandehuri lidhur me pranimin e fajësisë ka deklaruar se: E ndien veten fajtor për këto vepra penale duke shtuar se kërkoj falje publikisht që i kam kryer këto vepra, për shkak të rrethanave ekonomike skajshmërisht të dobëta, faktit se jetoj me dhjetë anëtar të familjes, nuk kemi asgjë tjetër përveç të ardhurave të cilat i realizojmë nga bujqësia, kemi aplikuar shumë herë për grante por gjithnjë jemi refuzuar, është penduar thellësisht për veprat që ka kryer dhe i është zotuar gjykatës se më asnjëherë nuk do të bie ndesh me ligjin dhe gjithashtu ka kërkuar që për shkak të këtyre rrethanave, t'i shqiptohet një dënim sa më i lehtë.

Prokurori, lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, ka deklaruar: pasi që janë përmbushur të gjitha kushtet për pranimin e fajësisë, e të cilin pranim i pandehuri e ka bërë në mënyrë vullnetare dhe pa presionin e askujt, gjithashtu pranimi i fajësisë duhet të merret nga gjykata si rrethanë lehtësuese duke pasë në konsideratë lartësinë e dënimit si dhe peshën e veprave penale të kryera nga i pandehuri.

Mbrojtësi i të pandehurit, av.Berat Peci, lidhur me pranimin e fajësisë nga i mbrojturi i tij, ka deklaruar: konsideroj se i mbrojturi im, pranimin e fajësisë e ka bërë pas konsultimeve të mjaftueshme me mua si mbrojtës, për benefitet që sjellë ky institut penal, i ka propozuar gjykatës që t'a pranoj pranimin e fajësisë. Sa i përket llojit dhe lartësisë së sanksionit penal, si mbrojtës e lus gjykatën që gjatë matjes dhe vendimin mbi dënimin, të merr si rrethanë posaçërisht lehtësuese pranimin e fajësisë nga i mbrojturi im, të ketë parasyshë edhe se kanë kaluar afër gjashtë vite nga koha e kryerjes së veprave penale, më parë nuk ka rënë ndesh me ligjin asnjëherë, jeton në kushte të rënda ekonomike duke u bazuar vetëm në të ardhurat që i realizon nga bujqësia.

Gjykata, ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilën e ka deklaruar i pandehuri, e në mbështetje të nenit 248 të KPP-së, në këtë drejtim vlerëson se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë për veprat penale për të cilat akuzohej. Gjykata ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit mbështetet në provat me të cilat disponon kjo gjykate si: Raporti fillestar i incidentit me numër të rastit 2017-KE-114 i datës 18.04.2017; Raporti i policit i datës 18.04.2017; Procesverbal mbi marrjen në pyetje të të dyshuarit Sh.H. me numër të rastit DHKEK-MV-03/2016 i datës 27.03.2017; Raporti mbi verifikimin e dokumenteve të humbura me numër referues të lëndës DH/2016-BC-1933; Vendim për refuzim të përkrahjes së projekteve për bujqësi dhe zhvillim rural 2016 me numër të protokollit 1730, e datës 29.06.2016; Formulari për aplikim për subvencione pranë Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë në MBPZHR me numër unik 97/11 e datës 31.03.2016; Biznes plani 2016; Çertifikata e regjistrimit të farmerit me numër identifikues 1049218; Certifikata e pronës në emër të A.B. e datës 01.03.2016; Procedimi i lëndës nga MBPZHR i datës 19.05.2016 me konstatimin se certifikata e pronësisë mbi tokën në emër të A.B. është e falsifikuar, dhe shkresat e tjera të lëndës.

Të gjitha këto prova janë bindëse për gjykatën dhe formojnë elementin inkriminues e që në bazë të këtyre provave dhe pranimit të fajësisë, është vërtetuar përtej çdo dyshimi se i pandehuri ka kryer veprat penale që i vihen në barrë.

Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë në mënyrë vullnetare, se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë mbështetet në provat që gjenden në shkresat e lëndës dhe poashtu se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, nga këto arsye gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri.

Gjykata, nga pranimi i fajësisë së të pandehurit dhe nga provat e cekura si më lart, ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se i pandehuri, me veprimet e tij, ka kryer veprat penale: Falsifikimi i dokumenteve nga neni 398 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, e për të cilën veprën penale është paraparë dënimi me gjobë ose me burgim deri në pesë (5) vjet si dhe veprën penale Mashtrimi me subvencione nga neni 336 paragrafi 1 lidhur me nenin 28 të KPRK-së e për të cilën veprën penale është paraparë dënimi me gjobë ose me burgim deri në pesë (5) vjet

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka vlerësuar si rethanat lehtësuese ashtu edhe ato rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së. Gjykata, si rrethana rënduese për të pandehurin, ka gjetur se i njëjti veprën e ka kryer me dashje direkte duke qenë plotësisht i vetëdijshëm për veprimet e ndërmarra dhe pasojat e veprës së tij, ashtu që këto vepra penale i ka kryer pasi që paraprakisht e kishte planifikuar fillimisht falsifikimin e certifikatës së pronës në mënyrë që t'i përmbushë kushtet formale për aplikim për subvencione dhe grante nga MBPZHR – Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë dhe me dokumentin e falsifikuar si pjesë e dokumentacionit për aplikim, kishte aplikuar për grantin në vlerë prej 70,000.00 (me fjalë: shtatëdhjetë mijë) euro, ku pas kontrollit të këtij dokumentacioni, ishte konstatuar se certifikata mbi pronësinë e tokës, ishte e falsifikuar.

Gjithashtu, si rrethanë të cilën Gjykata e ka marrë parasyshë me rastin e matjes së dënimit, është edhe motivi që ka shtyrë të pandehurin në kryerjen e këtyre veprave penale i cili motiv ishte i drejtuar kryekëput në përfitimin e kundërligjshëm pasuror duke tentuar që përmes dokumentacionit të falsifikuar, të përfitoj kundërligjshëm në dëm buxhetit të shtetit.

Ndërsa, si rrethana lehtësuese gjykata e ka vlerësuar pranimin e fajësisë në tërësi për veprat penale, faktin se i njëjti ka shprehur keqardhje dhe është penduar për ndodhjen e rastit, është i gjendjes së dobët ekonomike, është mbajtës i familjes dhe jeton me dhjetë anëtar dhe të hyrat e vetme që i realizon, janë nga bujqësia, është hera e parë që ka rënë ndesh me ligjin dhe i ka premtuar gjykatës se nuk do të kryej veprën tjetër penale.

Gjykata vlerëson se dënimi me burg me kusht ndaj të pandehurit është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprave penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Po ashtu, gjykata vlerëson se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41 të KPRK-së, që t'a parandaloj kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, si dhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit. Po ashtu, ky dënim do të shërbejë si masë preventive që në të ardhmen i pandehuri të përmbahet nga përfshirja në çfarëdo veprimi të kundërligjshëm.

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marrë në bazë të nenit 450 par. 2 pika 2.6 dhe nenit 453 par.1 të KPP-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet e paushallit gjyqësor. Ndërsa taksa për kompensimin e viktimave të krimit, në kuptim të nenit 39 par. 3 të Ligjit nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Andaj gjykata duke u bazuar në nenet 248, 365, 450, 453 të KPPK-ës nga arsyet e lartëcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
**Departamenti i Përgjithshëm**  
**P.nr.03/2020, datë 23.03.2022**

**Procesmbajtësi:**  
Bardh SYLEJMANI

**Gj y q t a r i:**  
Blerim HALIMI

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi, palët kanë të drejtë ankese në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, pas pranimit të të njejtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.